

INTERVISTË ME ENVER BAKIN

Prishtinë | Data: 14 tetor, 2017

Kohëzgjatja: 64 minuta

Të pranishëm:

- Enver Baki (I intervistuari)
- Ebru Süleyman (Intervistuesja)
- Donjeta Berisha (Kamerë)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Enver Baki: Unë jam Enver Baki, një nga intelektualët e parë të Kosovës, respektivisht të Prishtinës. Në përgjithësi më duket sikur jeta ime ka filluar me kulturë dhe do të përfundojë me të.

Ebru Süleyman: A mund të na flisni për kujtimet më të hershme që i mbani në mend?

Enver Baki: Natyrisht, natyrisht, do t'i tregoj edhe ato. Babai im, Sadiku u lind më 1898 në Prishtinë, nëna e cila është 15 vjet më e re se babai, një grua e re nga familja Seyh¹, u martua me babain tim. Familja e babait është në përgjithësi një nga familjet më të pasura të Prishtinës. Në bazë të asaj që më ka treguar ai, përgjatë epokës së Osmanëve, kjo familje ka pasur rreth nëntë fusha, shtatë vreshta dhe tri shtëpi. Kjo do të thotë se, bazuar në atë që më ka treguar babai, familja Baki ka qenë familje e madhe. Krejt shumë mirë, por sipas tij, përgjatë epokës Osmane, familja Baki ka tentuar të emigrojë në Turqi dy herë. Herën e parë në vitin 1921 dhe herën e dytë në vitin 1939. Për këtë arsye, kanë shitur gjithë pasurinë dhe pronat një nga një dhe kanë përfunduar në varfëri. Herën e dytë që u përballën me situatë të ngjashme, vëllezërit nuk arritën të dakordohen dhe nuk mundën të emigrojnë për në Turqi, kështu që qëndruan në Prishtinë. Sidoqoftë, ata nuk patën mundësi t'i blejnë prapë pronat e tyre të shitura dhe eventualisht përfunduan në varfëri, siç iu tregova. Në vitin 1947, domethënë menjëherë pas luftës në Kosovë, babai im u llogarit si një nga të pensionuarit e parë. Ndërkohë që unë jam i lindur më 1943. Para meje, babai dhe nëna ime kishin Kejseren, Fikrijen, Fitneten dhe motrën time më të vogël, Igballen. Ndër to, unë jam rritur dhe kam jetuar si mashkulli i vetëm në familje.

Sipas nënës sime, familja e saj, pra familja Seyh nuk iste prej familjeve më të pasura, por i kishin punët mirë gjithashtu. Tregimi i nënës time është kështu, teçja e cila është afër shkollës së mesme në Prishtinë, është teçja e saj. Në fakt, dy motra së bashku me kushërirën e tyre [vajzën e axhës] janë kujdesur për teçenë në atë kohë. Fatkeqësisht, duke qenë se nuk ka pasur trashëgimtar mashkull për të vazhduar kujdesin për të, ato u desh t'ia bartin teçenë vakufit². Kështu, sipas nënës time, teçja ime Zyrafja, nëna Mejremja së bashku me kushërirën e tyre zonjushën Ismete, u kujdesën për teçenë për kohë të gjatë, për mirëmbajtjen e saj. Rrjedhimisht, teçja kishte shumë vizitorë.

¹ *Seyh*: Etimologjikisht, përdorimi i parë i kësaj fjale (si Sheik) lidhej me udhëheqësit fisnorë të arabëve para-islamik. Në Ballkan, në komunitetin turk, fjala *Seyh* nënkupton udhëheqësin e fesë Shia, Sufi apo Bektashi.

² *Vakf*: I njohur edhe si vakuf, është institucion i prezantuar nga Perandoria Osmane i cili ishte përgjegjës për mbajtjen e shënimeve të komunitetit musliman të perandorisë dhe i cili në përgjithësi, brenda strukturës së vet përfshinte edhe një medrese. Ditëve të sotme, ky institucion njihet si Bashkësia Islame.

Në anën tjetër, kur flasim për kujtimet, do të doja të thoja shumë gjëra për Prishtinën. Fatkeqësisht ato karakteristika, karakteristikat e Prishtinës mungojnë sot. Prej asaj që kujtoj nga fëmijëria ime, në vend të taksive të ditëve të sotme, atëherë Prishtina kishte pajtonë në qytet. Gjithashtu fqinjë krijonin shoqëri dhe marrëdhënie të afërta në mënyrë shumë të mirë, përmes kapixhikut. Siç e dini, të gjitha familjet e vjetra në Prishtinë kishin kopshte përpos shtëpive të tyre, kopshte shumë të pasura në të cilat ata mbledhnin fruta dhe perime nga pemët të cilat i kishin mbjellur. Pra, në katër anët, kopshti i cili ka katër anë kishte nga një kapixhik në secilën anë. Kapixhikët kanë një vlerë të veçantë simbolike për mua. Sipas meje, ata ishin një përbërës që fuqizonte shoqëritë. Ishin vendtakime për të dashuruarit, sipas meje, për arsye se shumë njerëz, falë kapixhikut, burra dhe gra që ishin fqinjë, u dashuruan dhe u martuan. Mendoj se këto karakteristika mungojnë ditëve të sotme. Për më tepër, njerëzit, fqinjë në ndërtesa kolektive me gjashtë, shtatë, dhjetë kate, fatkeqësisht as që e njohin njëri-tjetrin. Mendoj se kjo nënkupton se shoqëritë e vjetra dhe lidhjet e ngushta janë vënë në hije.

Kur flasim për pajtonët, ata që shërbenin si taksi në Prishtinë nuk ishin të shumtë në numër. Pesë ose gjashtë prej tyre me siguri qëndronin në hapësirë të hapur përpara teatrit, përpara teatrit të sotëm, ata renditeshin njëri pas tjetrit dhe prisnin klientët. Përpos pajtonëve, njerëzit udhëtonin edhe me karroca. Këto kryesisht udhëtonin për në Gërmi, që ishte katër ose pesë kilometra larg Prishtinës, në parkun e Taukbaçës i cili ishte dy kilometra e gjysëm larg Prishtinës dhe gjatë bajramit, shumë shpesh shkonin në tyrben e Sulltan Muratit. Shumë familje, familjet e pasura, shkonin në këto vende me pajton ose me karrocë. Dy-tri familje bëheshin bashkë për të shkuar në Gërmi, Taukbaçe apo në tyrben e Sulltan Muratit, ata merrnin drekën me vete ose hanin darkë në këto vende të gjithë së bashku. Prandaj, vetëm desha t'i përmend disa prej këtyre elementeve tipike që më kujtohen, nuk e di nëse iu pëlqen apo jo...

Ebru Süleyman: Axha Enver, ju thatë, më treguat pak për qytetin, si pajtonët vendoseshin në hapësirën para teatrit të sotëm, duket se qyteti ka ndryshuar shumë prej atëherë? Në qytetin e vjetër, këtu, drejt xhamive... cilat vende kanë ndryshuar?

Enver Baki: Kur flasim për qytetin, në bazë të asaj që më kujtohet, Prishtina në përgjithësi kishte 14 xhami. Përndryshe, përpara Xhamisë së Çarshisë ishte një lagje e gjerë e cila kishte një vend që quhej lagjja e zejtarëve. Jorganxhinjtë, rrobaqepësit, berberët kishin dyqanet e tyre në shërbim të njerëzve. Por gjithashtu, në qendër të atij sheshi kishte një shadërvan, një prej shadërvanëve më të bukur në Prishtinë, sepse nuk kishte shumë, ishin rreth dy-tre të tillë, por ai në mes të atij sheshi ishte më i vlefshmi, me ujë të ftohtë që rridhte në çdo kohë. Kur flasim për shkollat...

Ebru Süleyman: Kur keni qenë i ri, ku shkonit me shokët tuaj në qytet, ku dilnit?

Enver Baki: Rinia e Prishtinës në përgjithësi, natyrisht, Prishtina kishte vetëm një teatër dhe një kinema. Përpos kinemasë dhe teatrit, ishin parqet e Gërmisë dhe Taukbaçës për të cilët iu tregova. Njerëzit mbledheshin atje, këndonin, luanin dhe vallëzonin.

Ebru Süleyman: Po në dimër?

Enver Baki: Gjatë dimrit, njerëzit e Prishtinës kryesisht rrinin në shtëpi dhe luanin me filxhana, lojën *tura*, kështu i kalonin netët e dimrit. Ne fëmijët, do t'iu tregoj pak për jetën time, babai im dinte më shumë se njëqind përralla, nëna ime dinte po aq apo më shumë këngë dhe këngë folklorike, njëloj motrat e mia këndonin *mani* [poezi folklorike] dhe na tregonin kashelashe gjithë kohës, motrat e mia më të mëdha. Kur shkonim për të fjetur, babai na mblidhte të gjithëve, mua dhe katër motrat e mia së bashku dhe na tregonte një përrallë, nëna mernte një tabak dhe na këndonte një këngë folklorike, sepse natyrisht që nuk kishim tarabuk apo def në shtëpi, pra ishte kështu. Njëra prej motrave mbante ritmin me lugë të drurit, ritmin muzikor. Në një mënyrë, kështu dukeshin të gjitha netët e dimrit, në anën tjetër, përndryshe, përrallat që na i tregonte babai, këngët e nënës dhe poemat e kashelashet të cilat na i tregonin shpesh motrat e mia, mendoj se të gjitha këto janë perla të letërsisë folklorike. I ndikuar nga këto perla, unë jam dashuruar me letërsinë folklorike turke dhe kam filluar të shkruaj poezi që nga shkolla fillore.

Më duhet gjithashtu të tregoj, ta përmend se viti 1951 ishte një momentum, një vit historik për turqit e Kosovës sepse në vitin 1951, turqit që jetonin në Kosovë fituan njohje edhe në sytë tanë edhe në sytë e publikut. Kjo domethënë se me 20 mars, 1951, bazuar në vendimin e Komitetit Krahinor të Kosovës, turqit që jetonin në Kosovë fituan të drejtat e tyre, pra në këtë vit, në vitet që pasuan... sepse e dini se në Mbretërinë Jugosllave, përpos medreseve nuk kishte shkolla të tjera ose shkolla fillore në gjuhën turke por pas vitit 1951, shkolla fillore dhe shoqata u formuan në qytete dhe fshatra të Kosovës ku jetonin turqit.

Ebru Süleyman: Në cilin vit keni filluar shkollimin?

Enver Baki: Më 1951, siç iu tregova.

Ebru Süleyman: Pra, më 1951 jeni regjistruar në shkollë?

Enver Baki: Shkollat janë hapur në vitin 1951, më 19... në të njëjtin vit në Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Gjiilan dhe Mamushë. Siç thamë, ishin dy fshatra, i pari Mamusha dhe i dyti Dobërçan, atje janë shkollat e para që janë hapur në gjuhën tonë, turqisht. Në ato vite, shkollat ishin të mbushura me nxënës, drejtorët e shkollave nuk kishin as mundësi të gjenin karrige për nxënësit, aq shumë që ishin, por...

Ebru Süleyman: Pra ju keni shkuar në klasë të parë në të njëjtin vit kur janë hapur shkollat në gjuhën turke?

Enver Baki: Atë vit kam filluar klasën e parë, jo në fakt... parashkollor, kam shkuar në parashkollor në gjuhën shqipe sepse nuk kishte shkollë në turqisht, sidoqoftë, në vitin 1951 jam transferuar nga shqipja në klasë turke. Për mua, aty ka nisur një jetë e re.

Ebru Süleyman: A të kujtohet klasa, mësuesit...

Enver Baki: Nuk kemi pasur shumë mësues, për të qenë i sigurtë, disa mësues ligjëronin dy, tri lëndë por me kohë, me rritjen e interesit për mësues dhe arsim, fëmijët tanë, rinia jonë filloi të diplomohet nga Shkollat e Larta Pedagogjike dhe poashtu kurse të gjuhës. Falë Syreja Jusufit, në Shkup filloi trajnimi i mësuesve. Atje janë trajnuar mësuesit tanë, por në vitet e para, mësuesit zgjidheshin ndër intelektualët e kohës. Pas përfundimit të trajnimit, duke filluar nga Prishtina deri në Dobërçan, mësuesit përcaktoheshin në mënyrë të organizuar për secilën shkollë në këto vende. Në trajnime nuk mësohej vetëm gjuha turke por gjithashtu matematika, fizika dhe poashtu trajnoheshin mësues për orët e muzikës.

Në këtë mënyrë, për një kohë të shkurtër u trajnuan një plejadë mësuesish, por jo vetëm arsimi, natyrisht që arsimi është shtylla e një komuniteti, por përpos asaj, formimi i shoqatave, rimëkëmbja e kulturës së një populli dhe mirëmbajtja e saj është poashtu e rëndësishme sipas mendimit tim. Shoqatat tona në atë kohë nuk ishin të rëndësishme vetëm për ruajtjen e këngëve tona, këngëve folklorike, valleve dhe traditave, por gjithashtu për zhvillimin e punës letrare. Sepse siç e dijmë, shoqatat kishin seksione të letërsisë që vazhdimisht punonin me folklor, grupin e korit, degën e valleve dhe degën e letërsisë. Kur janë formuar shoqatat e para, ato kanë krijuar një valë rimëkëmbje dhe njerëzit i mbanin traditat e tyre dhe më vonë këto shoqata botonin edhe revista. Sidoqoftë, në vitin 1969, me vendim të Unionit Socialist të Kosovës, Unioni Socialist i asaj kohe, u dakordua që në Prishtinë të fillojë operimin edhe një gazetë në gjuhën turke. Gazeta Tan³ erdhi në ekzistencë më 1 maj, 1969.

Ebru Süleyman: Mirë, axha Enver, do të doja t’iu pyes diçka. Në shkolla, në këto shoqata, në degët e tyre të letërsisë dhe më vonë në revista si dhe në gazetën Tan, a është shkruajtur në turqishte të ngjashme me atë të Turqisë, apo njerëzit shkruanin ndonjëherë edhe në turqishten tonë, apo është kryesisht turqishtja e Turqisë?

Enver Baki: Shiko, sipas mendimit tim nuk ekzistojnë gjuha e Turqisë, gjuha e Kosovës, gjuha e Maqedonisë, gjuha e Azerbejxhanit, por ekzistojnë dialekte. Secili popull ka dialekte dhe kështu natyrisht që gjuha në Turqi është gjuha jonë fundamentale e përdorur në territoret ku flitet turqishtja, por edhe dialektet që përdoren në mbarë botën janë njohur. Kështu, në fillim të gjithë kemi tentuar të përdorim gjuhën letrare të Turqisë, ka qenë një gjë e qëllimshme, por siç e dini, janë edhe dy gjuhë që e ngulfasin turqishten: persishtja dhe arabishtja. Në vitin 1928... në vitin ‘23 kur Ataturku erdhi në fuqi, u formua Shoqëria e Gjuhës Turke. Sipas kësaj shoqërie, gjuha turke që përdorej në Turqi dhe vende të tjera duhej pastruar nga fjalët e huaja. Pra, kishte një përpjekje për të lënë anash fjalët nga persishtja dhe arabishtja dhe për të përdorur fjalë origjinale turke. Nurullah Ataç kishte arritur sukses të dukshëm në kuptimin e largimit të fjalëve të huaja dhe rimëkëmbjes së gjuhës tonë. Natyrisht, ende sot e kësaj dite ekziston një ndikim i pamohueshëm i arabishtes dhe persishtes dhe shumë fjalë të cilave nuk mund t’iu gjendej ekuivalentja në turqishten origjinale përdoren ende nga këto gjuhë.

³ Tan: Bukvalisht do të thotë agim, është gazeta e parë në gjuhën turke në Kosovë. Ajo filloi të botohej më 1 maj, 1969 dhe u mbyll më 1992.

Ebru Süleyman: Ku ka vazhduar të ekzistojë turqishtja jonë, apo dialekti që e përdorim këtu, në folklor, përralla?

Enver Baki: Dialektet përgjithësisht krijohen përmes komuniteteve pa marrë parasysh nivelin e tyre të arsimimit, dialektet formulohen vetëvetiu dhe kryesisht me ndikime nga gjuhët tjera përreth. Për shembull, ekziston edhe dialekti i Prishtinës, ai i Prizrenit dhe ai i Mitrovicës. Kur i shihni ato, mund t'i vëreni dallimet, por në esencë ajo është turqishte. Për shembull, njerëzit e Mitrovicës thonë, “*Cürdünmi?*” [A e pe?], ndërkohë që ata të Prishtinës thonë, “*Coldunuzmi, cittinizmi?*” [A erdhe, a shkove?] Këto dallime dalin nga karakteristikat e dialekteve të ndryshme.

Tani, sa i përket shoqërive ose shoqatave, duhet thënë se ato kishin rol të rëndësishëm në zhvillimin kulturor të komunitetit turk në Kosovë sepse përveç degës së valleve folklorike, pjesëmarrësit e grupit të muzikës kanë marrë pjesë edhe në ngjarje të mëdha në Turqi, për të përfaqësuar kulturën e tyre. Njerëzit si Alush Nush, Bashkim Çabrat, Sevim Baku dhe shumë të tjerë janë kontribues të rëndësishëm në shoqatat tona. Si degë shtesë, seksionet e letërsisë janë gjithashtu të rëndësishme në këto shoqata jo vetëm se ia kanë mësuar turqishten rinisë, por edhe sepse kanë gdhendur tek fëmijët shprehinë e shkrimit dhe leximit të poezive. Duhet thënë gjithashtu se Peja, ku meqë ra fjala nuk ekziston shoqatë për arsye të çështjeve të emigrimit siç e dini që ka ndodhur nga viti '51 deri në vitin '56 dhe që nuk i ka përfshirë vetëm turqit por edhe shqiptarët e boshnjakët të cilët kanë emigruar për në Turqi nga Kosova në mënyrë masive.

Ebru Süleyman: A iu kujtohet? A keni parë njerëz duke u larguar së bashku?

Enver Baki: E kam një fotografi, do t'ua tregoj... Prishtina... kjo është fotografia në stacionin e trenit në Prishtinë, mijëra njerëz bashkoheshin për t'i përshëndetur të dashurit dhe të afërmit e tyre që largoheshin për në Turqi. Nuk ishte vetëm një ditë në javë, kjo ka zgjatur shumë, çdo ditë njerëzit mbushnin vagonat e trenit për të emigruar për në Turqi. Nga një perspektivë, mund të them se kjo na ka varfëruar. Nëse do të kishim më shumë njerëz në komunitet, do të kishim më shumë doktorë, inxhinierë, kujdestarë, mësues dhe intelektualë këtu. Fatkeqësisht, çështja e migrimit ka qenë shkaktar që këta numra potencialisht të lartë të zvogëlohen çdo herë e më shumë.

Ebru Süleyman: Axha Enver, a iu kujtohet cila ka qenë arsyeja kryesore e ikjes së njerëzve? Për shembull, a e dini, edhe njerëzit që qëndruan, pse kanë qëndruar?

Enver Baki: Tani, në disa prej familjeve, motrat dhe vëllezërit nuk mund të dakordoheshin për të ikur. Njoh disa njerëz ku njëri nga vëllezërit dëshironte të emigrojë në Turqi ndërsa tjetri nuk donte të shkone sepse t'i lësh të afërmit dhe të jesh vetëm është gjë e dhimbshme. Disa njerëz, sipas asaj që kam dëgjuar nga më të moshuarit, kanë shkuar në Turqi për arsye fetare, sepse ishin shumë fetarë. Sidoqoftë, si në çdo vend në Ballkan, ka mijëra xhami të mbetura nga epoka e Osmanëve ku shumë lehtë do të mund ta mbanim fenë tonë, sidomos nëse do të kishim numra më të mëdhenj ndoshta do të kishte edhe më shumë xhami, por emigrimi ka shkaktuar lëvizje dhe ndryshime masive. Tani, le të zhvendosemi në jetën tonë këtu sepse, njerëzit të cilët kanë emigruar janë në Turqi, i cili është atdhe për mua. Muslimanët, turqit kanë emigruar në Turqi në kohërat më të vështira për ta dhe Turqia i ka

hapur dyert kështu që në një mënyrë valët e emigrimit pas të 1920-tave, në vitet '22, '28, '34, '56, në të gjitha këto vite kishte emigrim masiv, jo vetëm nga Kosova, por turqit largoheshin nga të gjitha vendet e Ballkanit.

Ebru Süleyman: Dhe pasi të gjitha këto përfunduan, le të themi pas vitit '56 dhe të '60-tave e '70-tave kur këtu u vendos regjimi jugosllav, çfarë jete keni pasur?

Enver Baki: Por njerëzit që qëndruan, falë shoqërive të formuara nga këto shoqata, shkollat dhe xhamitë tona kishin mundësi të tregojnë prezencën e tyre këtu dhe ato kanë punuar shumë për të përforcuar ekzistencën e tyre këtu. Në këto 70 vjet jetë, kurrë nuk kam parë as kam dëgjuar për dikë që ka vdekur nga uria, as sa i përket atyre që janë larguar e as këtyre që kanë qëndruar këtu.

Ebru Süleyman: Po, por po pyes si ka qenë jeta këtu për ju, si ka ndryshuar jeta në punë dhe ajo shoqërore?

Enver Baki: Epo tani, secili shtet dhe territor ka karakteristikat e veta. Unë mendoj se njeriu është si bari, ku ka ujë dhe diell atëherë këto janë kushte të kënaqshme për jetesë. Njeriu është ashtu, nganjëherë pi qumësht nganjëherë nuk pi për arsye se detyrohet nga rrethanat. Tani, ne jemi me fat që kemi shkolla, shoqata dhe xhami sidomos për ata që janë fetarë. Natyrisht, ne të gjithë jemi muslimanë dhe e respektojmë fenë, shkojmë në xhami rregullisht. Këto kohë jo vetëm të moshuarit por edhe të rinjtë vizitojnë xhamitë.

Do të doja të flisja pak për gazetën “Tan”. Siç e dini, për turqit e Kosovës nuk kishte revista as gazeta deri në vitin 1969. Në vitin 1969, bazuar në vendimin e marrë nga Unioni Socialist i Kosovës, u formua gazeta “Tan” dhe edicioni i saj i parë u botua më 1 maj, 1969. Natyrisht, kjo ndërmarrje fillimisht kishte vetëm dhjetë apo pesëmbëdhjetë të punësuar, por sidoqoftë, më vonë ky numër u rrit në dyzetë, dhe përfshinte gazetarë, foto-reporterë, vozitës dhe redaktorë. Gazeta jonë u publikua rregullisht nga viti '69 deri në vitin '92. Në tre muajt e parë, ajo botohej çdo pesëmbëdhjetë ditë por më vonë kur u pajis me kuadrin e duhur, filloi të botohej çdo javë. Për më tepër, komuniteti turk, me qëllim të pasurojë jetën e vet kulturore dhe duke vepruar në përputhje me nevojat e tyre, filluan botimin e revistës “Çevren” më 1974.

Pjesa e Dytë

Ebru Süleyman: Në ato vite, 1960, '70, çfarë ke qenë duke bërë?

Enver Baki: Në vitin 1963, në fakt në vitin 1953 kur kam qenë nxënës i shkolëls fillore, fëmijët turk në Prishtinë përpos shkollës, e cila ishte shkolla fillore “Meto Bajraktari”, kanë pasur aktivitete jashtë-kurrikulave. Për shembull, teatri i fëmijëve në Prishtinë, i cili ishte i vendosur në zonën përpara radios, kjo ishte qendra për fëmijët. Në teatrin e fëmijëve, prodhohim dy deri në tri drama për një vit. Drejtimi i mikut tonë të vlefshëm i cili ishte artist në Teatrin Kombëtar të Kosovës, Mazhar Kadriu ka qenë vendosja e dramës në skenë. Fëmijët tanë në përgjithësi kalonin kohë atje dhe kënaqeshin.

Përpos Qendrës së Pionierëve dhe teatrit të fëmijëve, kishte edhe mbrëmje të filmit për fëmijë. Kam një imazh të mrekullueshëm në mendjen time, të dielave kur teatri i fëmijëve ishte i mbushur me fëmijë. Sepse kishte shfaqje për fëmijë qoftë në turqisht, shqip apo serbisht. Në këtë mënyrë, në një mënyrë shumë të organizuar, jo vetëm fëmijët sepse nuk dua të jem i padrejtë me prindërit, sepse nënat dhe baballarët ishin ata që i merrnin fëmijët për dore dhe shkonin bashkë me ta në shfaqje.

Poashtu Qendra e Pionierëve ishte e hapur pothuajse çdo ditë për fëmijë, kështu që edukatorët punonin me ta dhe prindërit shkonin aty bashkë me fëmijët e tyre. Një fakt tjetër është se ishte një mësues grupi i cili ishte rus, Ivani, i cili kishte organizuar një organizatë ambasadorësh në Qendrën e Pionierëve. Kjo do të thotë se çdo shtet evropian kishte një përfaqësues atje. Për shembull, kishte pesë përfaqësues nga shkolla fillore “Meto Bajraktari”, shtatë ose tetë nga ish “Vuk Karagjijqi” tani e njohur si “Elena Gjika”, pesë ose gjashtë të tjerë nga shkollat tjera zgjidheshin për të përfaqësuar shtetet evropiane në qendër. A ka ndonjë gjë më të vlefshme se kjo? Ishte mënyrë e mrekullueshme që fëmijët të mësonin për shtetet e tyre dhe edhe për shtetet tjera evropiane përmes kësaj organizate të simuluar. Gjithashtu, fëmijët kishin shëtitje, vizita në muze dhe gjëra të ngjashme të cilat gjithmonë iu sjellin një lloj tjetër gëzimi fëmijëve.

Përpos këtyre, siç iu tregova më herët, njerëzit kalonin kohë edhe në Gërmi, Taukbaççe dhe parkun e qytetit. Këto parqe ishin plot me njerëz dhe mund t'i dëgjoje tek këndonin nga të gjitha anët, sidomos komuniteti turk kalonte kohën e lirë atje.

Ebru Süleyman: Në ato momente, a bëheshit bashkë edhe me komunitetet tjera?

Enver Baki: Shumicën e kohës, kushdo që dëshironte të bashkohej mund të bashkohej. Mos të harrojmë se në atë kohë edhe serbët edhe shqiptarët flisnin turqisht shumë mirë. Të tri komunitetet jetonin në harmoni dhe kishin shoqëri.

Ebru Süleyman: Pra njerëzit flisnin gjuhët e njëri-tjetrit?

Enver Baki: Po, të gjithë. Sepse për aq sa di unë, Prishtina në vitin 1946 kishte rreth 16.000 banorë. Mendoje pak. Mos e konsidero sot, kur konsiderohet të jetë rreth 600.000 sipas statistikave. Por në vitin 1946 kishte vetëm 15.000-16.000 mijë dhe kjo do të thotë se të gjithë njiheshin mes vete, shumica prej tyre janë bërë të njohur dhe njerëzit e Prishtinës janë transformuar në një bashkësi. Mendoj se edhe emigrimi ka sjellë një hije në këtë afërsi dhe shoqëri. Nuk e di çka tjetër.

Ebru Süleyman: Në cilin vit keni filluar punën e parë? Kur keni filluar të punoni?

Enver Baki: Unë kam filluar punë si gazetar në Radio Prishtina në vitin 1962, pas diplomimit në shkollë të mesme, por le të themi se isha një lloj poeti gjatë kohës së shkollës. Sepse, si secili fëmijë unë fillova të shkarravis disa gjëra në shkollë fillore. Kam pasur poema, tregime. I ndjeri axha Syreja, Syreja Jusuf punonte në Radio Prishtina në atë kohë. Ai na ftonte nga “Meto Bajraktari”, mua, Nimetullah Hafizin dhe Nysret Dishon si poetë në edicionin e fëmijëve. Përpos asaj, poemat tona janë botuar në revistën

“Sevinç” në Shkup. Jo vetëm poemat po edhe gjëra të tjera si tregimet. Natyrisht, seksioni i fëmijëve në gazetën “Birlik” i botonte poezitë e mia në atë kohë.

Pas këtyre, kur autorët turq që krijonin letërsi në Kosovë filluan të botojnë në “Tan”, pasi që Prishtina kishte gazetën dhe revistat e saj, autorët çdo herë e më pak dërgonin veprat e tyre në Shkup për t’u botuar. Duke qenë se Prishtina kishte “Tan” si dhe revistat “Çevren” dhe “Kuş”. Më vonë, më 1974 “Tan” botonte seri librash. Veprat që botoheshin ishin shkrime, tregime dhe poema të krijuara nga turqit e Kosovës. Përbrenda kornizës së punës së këtyre serive të librave, rreth 250 libra janë botuar përgjatë 15 vjetëve. Këto janë përgjithësisht libra të autorëve turq nga Kosova. Ndër to libra të shkruajtur nga Hasan Merxhani, Nusret Disho, Nexhat Zekerija nga Shkupi. Librat e Shykry Ramos janë botuar këtu dhe shumë libra janë përkthyer. Për shembull, librat e shkruajtur nga Desanka Maksimoviç, Branko Çopiq dhe autorë të tjerë jugosllavë, edhe autorë shqiptarë që kanë krijuar veprat e tyre në Kosovë si për shembull Hasan Kërveshi... jo... Kërveshi, librat e Hasan Mekulit janë përkthyer dhe botuar në turqisht. Në një mënyrë, “Tan” mund të konsiderohet si qendra kulturore e turqve në Kosovë në atë kohë. Ky vend ishte një hapësirë jo vetëm për intelektualët, por edhe shumë politikanë të famshëm të Kosovës e kanë vizituar ekipin tonë në vazhdimësi. Meqë është pritur shumë mirë, grupe autorësh dhe poetësh turq nga Turqia, sa herë vizitonin Strugën pothausje çdo herë vizitonin edhe “Tan”. Pra përgjatë kësaj kohe...

Ebru Süleyman: A e keni ditur gjithmonë se do të dëshironit të punoni për radion dhe për “Tan”, apo se do të ishit shkrimtar? A keni pasur gjithmonë dëshirë të jeni shkrimtar?

Enver Baki: Siç e kam thënë qysh në fillim, këngët që i këndonte nëna ime, përrallat e babait tim, poemat dhe kashelashet e motrës sime më kanë mbushur me dashuri për letërsinë folklorike. Në këtë mënyrë, kur gdhendesh njëherë, zemra jote nuk mund të pushojë pa shkruajtur, pa shkruajtur poema, tregime... në fakt, Syreja Jusuf, profesori im njëherë më tha, “Enver, më pëlqejnë poemat e tua por do të doja të të shihja duke shkruajtur tregime”. Duke e thënë këtë gjë në mënyrë shumë të sjellshme, ai më shtyu të shkruaj tregime dhe kështu tani kryesisht njihem si Enver Baki, autori i tregimeve dhe tregimeve për fëmijë më shumë sesa si poet në komunitetin e shkrimtarëve turk të Kosovës. Sidoqoftë, kam vazhduar të shkruaj në të dy degët. Deri më sot, kam botuar 15 libra. Disa prej tyre janë tregime për fëmijë, disa poema për fëmijë dhe disa të tjerë në formë të tregimeve dhe poemave janë të dedikuara për audiencë të rriturish. Mendoj, nëse do të kishte më shumë mundësi financiare, do të botoja edhe më shumë, duke qenë se kam tre libra në dorëshkrim. I pari është “*Priştine Yaşlıları*” [Të moshuarit e Prishtinës], i dyti “*Sevişen Kuzenler*” [Të dashur kushërinj] dhe i treti “*Priştine Masalları*” [Përralla Prishtine].

Në punën time letrare, duke botuar 15 libra kam fituar pak famë si Enver Baki dhe rrjedhimisht më janë dhënë shumë çmime. Për shembull, me librin tim “*Mutlu Baba*” [Baba i lumtur], i botuar në kuadër të botimeve të “Tan”, me një libër tjetër “*Beş Kardeşler*” [Pesë motra dhe vëllezër], më janë dhënë çmime. Për më tepër, në vitin 1967, Shoqëria e Shkrimtarëve Turq në Kosovë më ka ndarë një çmim poashtu.

Ebru Süleyman: A është ende aktive kjo shoqëri?

Enver Baki: Më fal?

Ebru Süleyman: A funksionon ende kjo shoqëri?

Enver Baki: Po. Më 1964 shoqata Dogruyol e Prizrenit më dha çmimin për shërbimin Sylejman Brina. Përpos asaj, Ministria e Kulturës dhe Departamenti i Kulturës në Prishtinë më kanë dhënë çmime mirënjohje që më kanë bërë shumë të lumtur. Ka pasur shumë shoqata të tjera me të cilat kam bashkëpunuar të cilat më kanë dhënë çertifikata mirënjohje dhe më kanë ftuar në ceremoni të ndryshme. Mendoj se nuk jam njeri që ndonjëherë do t'i duken të mjaftueshme krijimet letrare, prandaj unë gjithmonë vazhdoj të shkruaj, edhe në këtë moshë. Vitin e kaluar, mësimdhënësit dhe nxënësit e shkollës fillore "Elena Gjika" kanë organizuar një orë letrare ku më kanë ftuar për të prezantuar dhe promovuar dy librat e mi të ri "İki Yürek" [Dy zemra] dhe "O da Çocuktur" [Edhe ai/ajo është fëmijë] në këtë takim ishte edhe ambasadori i Turqisë në Kosovë, së bashku me drejtorin e institutit Yunus Emre dhe shumë miq të mi e njerëz që vlerësojnë letërsinë tonë. Gjithmonë kam thënë se edhe pse jam 74 vjeç, me vullnetin e Zotit, do të doja të botoj 74 libra.

[Intervista është ndërprerë me kërkesën e të intervistuarit]

Për shembull, në Vushtri, Mitrovicë e Prishtinë, kur janë formuar shoqatat, edhe kur Stevan Moranjac është themeluar rreth vitit 1958, ka operuar jo vetëm në një, por në tri gjuhë. Pas kësaj, kur njerëzit tanë filluan të largohen, numri i fëmijëve u zvogëlua dukshëm. Edhe në shkolla, edhe në shoqata, ky numër ishte zvogëluar dhe në fakt, Yeni Hayat nuk mundi të funksiononte për disa vite. Sidoqoftë, në vitin 1969 Yeni Hayat ndërroi emrin në Gerçek dhe u fuqizua. Prandaj, Remzi Sylejman është themeluesi dhe drejtori i parë i Yeni Hayatit dhe ky është fakt historik i cili nuk mund të fshihet. Pas tij, vëllai Sherafedin, Sherafedin Sylejman iu bashkua stafit si asistent për të drejtuar shoqërinë Yeni Hayat. Bashkë me vëllezërit Remzi dhe Sherafedin, ky vend bashkoi edhe emra të tjerë si Rashit Bejtulla, Nexhmedin Goriça, vëllaun Syreja, Enver Baki, Mehmet Ustaibo, Shakir Maksut dhe shumë shokë të tjerë të ri të cilët filluan të jenë aktivë në kuadër të kësaj shoqate e cila në atë kohë quhej Gerçek.

Po flas për këtë por kishte edhe shoqata të tjera si Dogru Yol në Prizren, Birlık në Mitrovicë, Rashit Deda në Vushtrri, të gjitha këto punuan në tri degë kryesore në të gjitha kohërat. Në atë mënyrë, të gjitha komunitetet lidheshin mes vete përmes këtyre shoqatave. Nëse organizohej një koncert, ne ftonim dy këngëtarë dhe vokalistë nga shqiptarët, një nga serbët dhe në këtë mënyrë programet ishin goxha të pasuruara me diversitet. Më vonë, organizonim gjithashtu orë letrare së bashku me shkrimtarë nga komunitetet tjera. Enver Gjerçeku, Rifat Kukaj, Vehbi Kikaj dhe Qamil Batalli më kujtohen, ata ishin pothuajse gjithmonë të pranishëm në orët letrare që organizonim. Në këtë mënyrë ne krijonim programe dhe bashkoheshim.

Kur flasim për njerëzit tanë, sa i përket kohës sonë të lirë e kam përmendur Gërminë dhe Taukbahçen, një numër i madh i shqiptarëve shpesh na bashkoheshin në këto ndeja. Sepse ne nuk kishim dallime shumë të mëdha, qyteti ishte i vogël. Çfarë është një popullatë prej 16.000 banorësh sot? Mund të

ishite vetëm një rrugë, as një lagje e plotë në qytete si Stambolli e Izmiri apo ndonjë qytet tjetër i ngjashëm për nga madhësia. Në fjalë të tjera, ne ishim të afërt me njëri-tjetrin. Megjithatë, kishte raste kur edhe vëllezërit në familje grinden, disa erëra të ftohtë kanë fryrë ndër komunitete poashtu kohë pas kohe, më duhet të shtoj poashtu se këto kanë ndodhur për shkak të disa nacionalistëve. Kaq mund të them për njerëzit dhe fëmijët tanë.

Kur flasim për “Tan”, pas themelimit të gazetës në vitin 1969, drejtori ynë i parë ishte Sylejman Brina nga Prizreni dhe në atë kohë unë isha në detyrën e zëvendës drejtorit. Për një kohë të gjatë kam udhëhequr revistën “Çevren” si autor korrespondent. Gjithashtu përmes gazetës “Tan” kam kontribuar shumë në botimin e revistës “Kuq”. Si sekretar i këtyre revistave, mbledhja shkrimtarë shqiptarë, turq dhe serbë për të organizuar orë letrare së bashku. Siç iu tregova, përmes serive të librave, librave të shkruajtur nga Pero Stefanoviq, Muahmed Kërveshi, Esat Mekuli, Darinka Jevriq dhe shumë shkrimtarë të tjerë nga Kosova.

Ebru Süleyman: E keni përmendur radion dhe orkestrën atje...

Enver Baki: Po, ju kërkoi falje edhe juve edhe shikuesve sepse harrova të ndalem. Do të doja të thoja poashtu se ka edhe diçka për të shtuar në vargun e ngjarjeve që filluan më 1951 kur shkollat u bënë funksionale, shoqatat formoheshin dhe Radio Prishtina kishte transmetim në turqisht dhe këtu ndodhë themelimi i Orkestrës së Radio Prishtinës për Muzikë Klasike Turke e cila ka kontribuar shumë në zhvillimin kulturor të turqve të Kosovës. Para vitit ‘51, kishte dy orkestra kryesore në Kosovë të cilat përpos që luanin në ndejat që i përmenda më herët në Gërmi dhe Taukbahçe, luanin edhe dasmat tona, në organizime të tjera dhe në mbledhje të shoqërisë ku shtonin edhe ngjyrën e muzikës. Njëra prej tyre drejtohej nga Salih Trashoba, axha Salih, dhe e dyta nga Sherif Nani, të dy ishin artistë. Salih Hovarda ishte punëtor në Zadrugë [kooperativë] por luante në *oud* [instrument me tela] me mjeshtëri të rrallë dhe prandaj kishte orkestrën e tij e cila përbëhej nga tre deri në katër njerëz.

Në anën tjetër, Sherif Rexhep Seyh, i cili është daja im dhe i cili ishte berber, gjithmonë kishte një tarabuk ose një def në dyqan dhe në shtëpi. Ai gjithashtu kishte një grup muzikor të përbërë prej tre deri në katër njerëz. Këto dy grupe, në vitet e para të Radio Prishtinës, në vitin 1951 luanin muzikë duke qenë se nuk kishte teknologji për t’i inçizuar dhe kështu ata pasuronin transmetimin tonë me muzikë.

Më vonë, Sherafedin Sylejman, i cili ishte personi përgjegjës për transmetimin turqisht në Radio Prishtina në vitin 1952, kishte dëgjuar lëvdata dhe shumë fjalë të mira nga Rasim Salih dhe e sollti atë nga Mitrovica në Prishtinë dhe kështu u formua Orkestra e Muzikës Klasike Turke në Radio Prishtina. Siç më kujtohet, Sherafedin Sylejman ishte poshtu moderator në radio dhe rreth vitit ‘51, si dhe drejtor i redaksisë, ai ftoi Rasim Salihin këtu, ai pranoi dhe një orkestër e re u formua. Falë orkestrës dhe vëlla Rasimit, muzicientë të dalluar janë sjellë jo vetëm në Prishtinë por në shumë vende në Kosovë. Kështu, njerëzit tanë jo vetëm që kishin orkestrën, por edhe një seksion turk në Radio Prishtina.

Më herët më bëtë një pyetje në lidhje me kohezionin dhe asaj që kishte ndodhur pas luftës socialiste. Siç e dini, atëherë, një nga qëllimet më të mëdha të Unionit Jugosllav Komunist ishte të sigurohen të drejtat për të gjitha komunitetet pa marrë parasysh a janë minoritet apo jo. Në këtë kontekst, turqit e Kosovës fituan të drejtat për përdorimin e gjuhës dhe fituan të drejtat kulturore në nivel të barabartë me komunitetet tjera. Ndoshta nuk duhet të them komunitet minoritet sepse edhe në Kosovë turqit janë minoritet, në Evropë dhe në botë janë më shumë se 250 milionë turq dhe prandaj mendoj se nuk duhet ta konsiderojmë veten minoritet. Faleminderit!

Ebru Süleyman: S'ka përse. Nëse doni mund ta vazhdojmë bisedën edhe pak?

Enver Baki: Nuk do të dija çfarë të thoja.

Ebru Süleyman: Ndoshta mund të flasim për ditët e sotme, të afrohem në të tashmen?

Enver Baki: Sa i përket të tashmes, nuk di çfarë të them. Shoqatat punojnë, radio punon, nuk ka shumë për të thënë. Sidoqoftë, mund ta mbyllim intervistën me një fjali. A mundemi?

Ebru Süleyman: Si të dëshironi atëherë, le ta mbyllim me një fjali.

Enver Baki: Disa njerëz po punojnë, po punojnë dhe po krijojnë gjëra. Nuk di çfarë tjetër të them. Nuk mund të ankohe mi, por plaga ende gjakon (buzëqeshë) {drejton gishtin kah zemra}.

Ebru Süleyman: Në rregull, çfarëdo që dëshironi të shtoni, ndihuni i lirë.

Enver Baki: Më duhet ta them këtë. Ndër shumë njerëz që jetojnë në Kosovë, turqit janë duke e mbajtur praninë e tyre dhe aktivitetet përmes institucioneve të tyre, shoqatave, arsimit dhe shkollave. Ngjashëm me komunitetet e tjera, komuniteti turk ka të metat e veta por në vend se të flas për të metat, do të më pëlqente të thoja se jam i kënaqur me gjendjen tonë aktuale.

Ebru Süleyman: Faleminderit!